



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PROKURORIA E POSAÇME**  
**KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**  
**TIRANË**

Nr. 364/2 Prot./ (E.M.)

Tiranë, më 21-04.2021

**Lënda:** Dërgohet kallzim penal për kompetencë

**DREJTUAR:** **PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË**  
**KAVAJË**

**PËR DIJENI:** **PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË**  
**TIRANË**

Me shkresat nr. 67 prot datë 16.04.2021 dhe nr. 67/1 prot datë 18.04.2021, Partia Demokratike e Shqipërisë, ka paraqitur kallzim penal duke pretenduar se Bashkia Rrogozhinë, ka kategorizuar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullues disa banesa të dëmtuara si DS4 dhe DS5 kur fillimisht ato janë kategorizuar me dëmtime si DS1, DS2 dhe vetëm 20% e tyre si DS3. Gjithashtu, Këshilli Bashkiak Rrogozhinë, në një mbledhje të datës 12.04.2021, ka vendosur të përfshijë disa banesa/familje si përfituese nga fondet e rindërtimit duke u kategorizuar në kundërshtim me kuadrin ligjor, si DS4 dhe DS5. Në këtë kuadër janë dhënë edhe grante për rindërtim etj. Një pjesë e familjeve, banesat e të cilëve madje nuk janë dëmtuar fare, kanë përfituar grante për ndërtim për shkak të lidhjeve me punonjës të Njësisë administrative apo fakti se janë punonjës të njësisive administrative apo bashkisë Rrogozhinë.

Pavarësisht pretendimeve që ngrihen nga kallzuesi për funksionarë të lartë apo vepra penale me elementë korruptivë, konstatohet se nuk ofrohet, asnjë e dhënë apo indicie, që të mbështesë këto pretendime.

Ndodhur në këto kushte, vlerësohet se duhet të kryhen verifikime në lidhje me faktet e pretenduara, të cilat nga të dhënat e ofruara deri më tani konstatohet se orientohen në drejtim të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, “Falsifikimit të dokumentave” dhe “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” parashikuar respektivisht nga nenet 248, 186 dhe 328/a të K.Penal.

Përsa më sipër ju përcillet për kompetencë materiali kallzues i mësipërm, pasur parasysh kompetencen lëndore dhe territoriale, në respektim të n. 75/a, 76 dhe 28 të K.Pr.Penale.

Duke ju falenderuar për mirekuptimin!

**DREJTUESI I PROKURORISË**  
**ARBEN KRAJA**

